

KAPITUJT QË UDHËHEQ-MEI	PËRMBAJTJA E KAPITULLIT	CHAPTER SUMMARY
LEAD CHAPTERS - MEI	SHQIP	ANGLISHT
AL KAPITULLI 1 LËVIZJA E LIRË E MALLRAVE	Lëvizja e lirë e mallrave është një nga katër liritë themelore të tregut të brendshëm të BE-së, së bashku me lëvizjen e lirë të njerëzve, shërbimeve dhe kapitalit. Qëllimi i saj është krijimi i një zone pa kufij të brendshëm, duke eliminuar barrierat e pajustificuara për tregtinë midis Shteteve Anëtare të BE-së. Për të lehtësuar integrimin pa rregullim të tepërt, BE-ja miratoi "Qasjen e Re" ndaj harmonizimit (Libri i Bardhë, 1985), që përcaktojnë kërkesat thelbësore për sigurinë e produkteve. Zbatimi efektiv kërkon institucione të forta - të tilla si një autoritet funksional i mbikëqyrjes së tregut dhe organe kombëtare të standardizimit - si dhe bashkëpunim të ngushtë me doganat dhe agjencitë e tjera zbatuese	The free movement of goods is one of the EU internal market's four fundamental freedoms, together with the free movement of people, services, and capital. It aims to create an area without internal borders, removing unjustifiable trade barriers between EU Member States. To encourage integration without overregulation, the EU implemented the "New Approach" to harmonisation (White Paper, 1985), which outlined the essential requirements for product safety. Effective enforcement requires strong institutions, such as a functional market surveillance authority and national standardization bodies, as well as close collaboration with customs and other enforcement authorities.
ENG CHAPTER 1 FREE MOVEMENT OF GOODS		
AL KAPITULLI 2 LËVIZJA E LIRË E PUNËTORËVE	Trajton të drejtën themelore të qytetarëve të Bashkimit Evropian për të punuar dhe jetuar lirshëm në çdo shtet anëtar, pa diskriminim mbi bazën e kombësisë. Ky kapitull përfshin rregullat që garantojnë aksesin në tregun e punës, të drejtat për anëtarët e familjes, si dhe koordinimin e sistemeve të sigurimeve shoqërore ndërmjet shteteve. Ai mbështetet në nenin 45 të Traktatit për Funksionimin e BE-së dhe është një komponent kyç i tregut të brendshëm. Në Shqipëri, zbatimi dhe negociimi i këtij kapitulli drejtohet nga Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit.	Addresses the fundamental right of European Union citizens to work and live freely in any member state, without discrimination based on nationality. This chapter includes rules that guarantee access to the labor market, rights for family members, as well as the coordination of social security systems between states. It is based on Article 45 of the Treaty on the Functioning of the EU and is a key component of the internal market. In Albania, the implementation and negotiation of this chapter is led by the Ministry of Economy, Culture, and Innovation.
ENG CHAPTER 2 FREE MOVEMENT OF WORKERS		

AL KAPITULLI 3 E DREJTA E VENDOSJES DHE LIRIA PËR TË OFRUAR SHËRBIME	Trajton të drejtën e themelimit dhe lirinë për të ofruar shërbime, synon të garantojë që qytetarët dhe subjektet juridike të BE-së të mund të krijojnë biznese dhe të ofrojnë shërbime në gjithë territorin e BE-së pa barriera të panevojshme ligjore. Ky kapitull përfshin rregulla për njohjen reciproke të kualifikimeve profesionale, me qëllim lehtësimin e lëvizjes së profesionistëve midis shteteve anëtare, si dhe dispozita për liberalizimin gradual të tregut postar duke ruajtur detyrimin për shërbim universal brenda një kuadri të rregulluar.	Addresses the right of establishment and the freedom to provide services, aims to ensure that EU citizens and legal entities can create businesses and offer services throughout the EU territory without unnecessary legal barriers. This chapter includes rules for the mutual recognition of professional qualifications, with the purpose of facilitating the movement of professionals between member states, as well as provisions for the gradual liberalization of the postal market while maintaining the obligation for universal service within a regulated framework.
ENG CHAPTER 3 RIGHT OF ESTABLISHMENT AND FREEDOM TO PROVIDE SERVICES		
AL KAPITULLI 6 LEGJISLACIONI PËR SHOQËRITË TREGTARE	Qëllimi i këtij kapitulli është të sigurojë që legjislacioni kombëtar mbi shoqëritë tregtare, qeverisjen korporative dhe deklarimin financiar të jetë plotësisht në përputhje me standardet e BE-së. Ai mbulon rregullat mbi formimin, funksionimin dhe shpërbërjen e shoqërive tregtare, mbrojtjen e aksionarëve dhe kreditorëve, si dhe detyrimet për transparencë dhe deklarim.	The purpose of this chapter is to guarantee that national legislation on companies, corporate governance, and financial reporting is fully compliant with EU standards. It covers rules governing company creation, operation, and dissolution, shareholder and creditor protection, and transparency and reporting requirements. The <i>acquis</i> also includes requirements for company accounting and auditing, as well as assuring financial information reliability and market confidence. Albania's goal is to modernize company legislation, increase investor trust, and promote business integration into the European single market.
ENG CHAPTER 6 LEGISLATION ON COMMERCIAL COMPANIES		

AL KAPITULLI 7 E DREJTA E PRONËSISË INTELEKTUALE	Qëllimi kryesor i këtij kapitulli është të sigurojë mbrojtjen dhe zbatimin efektiv të të drejtave të pronësisë intelektuale (DPI) në përputhje me standardet e BE-së. Ai përfshin të drejtën e autorit dhe të drejtat e lidhura, markat tregtare, dizenjot, patentat, treguesit gjeografikë, si dhe masat kundër falsifikimit dhe piraterisë. Mbrojtja e fortë e pronësisë intelektuale garanton inovacionin, kreativitetin dhe konkurrencën e ndershme, duke nxitur investimet dhe integrimin në tregun e përbashkët të BE-së.	The main goal of this chapter is to ensure the effective protection and enforcement of intellectual property rights (IPR) in line with EU standards. It covers copyright and related rights, trademarks, designs, patents, geographical indications, and enforcement measures against counterfeiting and piracy. Strong IPR protection safeguards innovation, creativity, and fair competition, while also encouraging investment and integration into the EU single market.
ENG CHAPTER 7 INTELLECTUAL PROPERTY LAW		
AL KAPITULLI 20 NDËRMARRJET DHE POLITIKAT INDUSTRIALE	Politika industriale synon të nxisë konkurrueshmërinë duke përsheptuar ndryshimet strukturore, duke inkurajuar një mjedis të favorshëm për krijimin dhe rritjen e biznesit në të gjithë BE-në, si dhe për investimet vendase dhe të huaja. Politika industriale përbëhet nga parimet, komunikimet, forumet e konsultimit dhe programet e Komunitetit që promovojnë koordinimin e politikave të NVM-ve në të gjithë tregun e brendshëm bazuar në një përkufizim të përbashkët të NVM-ve Për Shqipërinë, përputhja me këtë kapitull është thelbësore për të nxitur rritjen e sektorit privat, për të rritur konkurrueshmërinë e NVM-ve dhe për të siguruar që industritë të mund të përshtaten me sfidat e tregut të vetëm të BE-së dhe tranzicioneve të gjelbra/dixhitale.	Industrial policy aims to boost competitiveness by accelerating structural change, encouraging an environment favourable to business creation and growth throughout the EU as well as domestic and foreign investments. The policy is driven by principles, communications, consultation forums, and Community programs promoting SME policy coordination across the internal market with a common SME definition. Albania's conformity to this chapter aims to strengthen the private sector and boost the competitiveness of SMEs, ensuring that industries can adapt to the difficulties of the EU single market and green/digital transitions.
ENG CHAPTER 20 ENTERPRISES AND INDUSTRIAL POLICIES		

AL KAPITULLI 30 MARRËDHËNIET ME JASHTË	Kapitulli i Marrëdhënieve të Jashtme përfshin legjislacionin që lind nga ndërveprimet ekonomike dhe tregtare të Bashkimit Evropian me vendet e treta dhe organizatat ndërkombëtare, përveç bashkëpunimit ndërkombëtar dhe ndihmës humanitare. Akte legjislative në këtë fushë përbëhen kryesisht nga legjislacioni i detyrueshëm direkt i BE-së, i cili nuk kërkon transpozim në ligjin kombëtar. Vendet kandidate pritet të harmonizojnë politikat e tyre në mënyrë progresive me BE-në në lidhje me marrëdhëniet me vendet e treta dhe organizatat ndërkombëtare.	The External Relations Chapter includes legislation that arises from the economic and commercial interactions of the European Union with third countries and international organizations, in addition to international cooperation and humanitarian assistance. The acquis in this field consists mainly of directly binding EU legislation which does not require transposition into national law. Candidate countries are expected to align their policies progressively with the EU with respect to relations with third countries and international organisations.
ENG CHAPTER 30 EXTERNAL RELATIONS		
KAPITUJT ME BASHKËNEGOCIM CO-NEGOTIATION CHAPTERS	PËRMBAJTJA E KAPITULLIT SHQIP	CHAPTER SUMMARY ANGLISHT
AL KAPITULLI 4 LËVIZJA E LIRË E KAPITALIT	Qëllimi i lëvizjes së lirë të kapitalit është të mundësojë një zbatim efikas të kapitalit fizik dhe financiar për qëllime investimi dhe financimi përtej kufijve. Ai përfshin heqjen e kufizimeve mbi lëvizjen e kapitalit, përfshirë investimet e huaja direkte, blerjen e pasurive të paluajtshme, tregtimin e letrave me vlerë dhe transfertat ndërkufitare të pagesave dhe kredive. Për Shqipërinë përafrimi nën këtë kapitull kërkon gjithashtu masa të forta mbrojtëse kundër rreziqeve si pastrimi i parave, financimi i terrorizmit dhe flukset e paligjshme financiare, duke garantuar që liberalizimi të shoqërohet me stabilitet dhe siguri financiare.	The main goal of this chapter is to ensure free movement of capital and to enable an efficient cross-border deployment of physical and financial capital for investment and financing purposes. It covers the elimination of restrictions on capital movements, including foreign direct investment, real estate purchases, securities trading, and cross-border credit and payments. For Albania, alignment under this chapter also requires strong safeguards against risks such as money laundering, terrorist financing, and illicit financial flows, ensuring that liberalization goes hand in hand with financial stability and security.
ENG CHAPTER 4 FREE MOVEMENT OF CAPITAL		

AL KAPITULLI 19 POLITIKAT SOCIALE DHE PUNËSIMI	Trajton përafrimin e legjislacionit kombëtar me atë të Bashkimit Evropian në fusha që lidhen me të drejtat dhe kushtet e punës, mbrojtjen sociale, barazinë gjinore, luftën kundër diskriminimit, sigurinë dhe shëndetin në punë, si dhe përfshirjen sociale të grupeve të marginalizuara, përfshirë personat me aftësi të kufizuara. Ky kapitull gjithashtu mbulon politikat e punësimit, funksionimin e dialogut social ndërmjet sindikatave dhe punëdhënësve, të drejtën për organizim sindikal dhe grevë, si dhe pjesëmarrjen e partnerëve socialë në hartimin e politikave. Ai synon të sigurojë një qasje gjithëpërfshirëse për promovimin e drejtësisë sociale dhe integritit në tregun e punës.	Addresses the approximation of national legislation with that of the European Union in fields related to labor rights and conditions, social protection, gender equality, combating discrimination, occupational health and safety, as well as the social inclusion of marginalized groups, including persons with disabilities. This chapter also covers employment policies, the functioning of social dialogue between trade unions and employers, the right to organize and strike, as well as the participation of social partners in policymaking. It aims to ensure a comprehensive approach to promoting social justice and integration into the labor market.
ENG CHAPTER 19 SOCIAL POLICIES AND EMPLOYMENT		
AL KAPITULLI 28 MBROJTJA E KONSUMATORIT DHE SHËNDETI PUBLIK	Trajton përafrimin e legjislacionit shqiptar me rregullat dhe standardet e Bashkimit Evropian në fushat e mbrojtjes së konsumatorit dhe shëndetit publik. Qëllimi kryesor është sigurimi i një niveli të barabartë mbrojtjeje për konsumatorët shqiptarë, krahasuar me ata të vendeve anëtare të BE-së. Ky kapitull përfshin harmonizimin e rreth 148 akteve të BE-së deri në vitin 2027 dhe konsiderohet një proces sfidues por strategjik, me ndikim afatgjatë në përmirësimin e cilësisë së jetës në Shqipëri. Ministritë përgjegjëse e konsiderojnë këtë reformë si një përpjekje të përbashkët, duke vënë në qendër bashkëpunimin me partnerët institucionalë dhe shoqërinë civile.	Addresses the approximation of national legislation with the rules and standards of the European Union in the fields of consumer protection and public health. The main objective is to ensure an equal level of protection for Albanian consumers compared to those in EU member countries. This chapter includes the harmonization of around 148 EU acts by 2027 and is considered a challenging but strategic process, with long-term impact on improving the quality of life in Albania. The responsible ministries consider this reform a joint effort, placing cooperation with institutional partners and civil society at the center.
ENG CHAPTER 28 CONSUMER PROTECTION AND PUBLIC HEALTH		

KAPITUJT KONTRIBUES	PËRMBAJTJA E KAPITULLIT SHQIP	CHAPTER SUMMARY ANGLISHT
AL KAPITUJT KONTRIBUES	Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit (MEI), përveç kapitujve ku ka rol lider apo bashkë-negociues, kontribuon edhe në një sërë kapitujsh të tjerë të acquis, duke ofruar ekspertizë dhe mbështetje teknike në fushat që lidhen me ekonominë, tregtinë dhe inovacionin. Në Kapitullin 8 “Politika e Konkurrencës”, MEI kontribuon në drejtim të përputhjes së skemave të ndihmës shtetërore me rregullat e BE-së. Në Kapitullin 10 “Shoqëria e Informacionit dhe Media” dhe Kapitullin 11 “Bujqësia dhe Zhvillimi Rural”, roli i MEI lidhet me aspektet horizontale të digjitalizimit, inovacionit dhe mbështetjes për zinxhirët e vlerës. Në Kapitullin 22 “Politika Rajonale dhe Koordinimi i Instrumenteve Strukturore” dhe Kapitullin 23 “Gjyqësia dhe të Drejtat Themelore”, kontributi i MEI është i lidhur me politikat e zhvillimit rajonal, garantimin e një mjedisi të favorshëm biznesi dhe respektimin e të drejtave ekonomike. Ndërsa në Kapitullin 29 “Bashkimi Doganor”, MEI mbështet procesin me ekspertizë mbi politikat	The Ministry of Economy, Culture, and Innovation (MEI), in addition to the chapters where it serves as lead or co-negotiator, also contributes to several other acquis chapters by providing expertise and technical support in areas related to the economy, trade, and innovation. In Chapter 8 “Competition Policy”, MEI contributes to aligning state aid schemes with EU rules. In Chapter 10 “Information Society and Media” and Chapter 11 “Agriculture and Rural Development”, its role is linked to horizontal aspects of digitalization, innovation, and support for value chains. In Chapter 22 “Regional Policy and Coordination of Structural Instruments” and Chapter 23 “Judiciary and Fundamental Rights”, MEI contributes through policies on regional development, creating a favorable business environment, and ensuring respect for economic rights. Meanwhile, in Chapter 29 “Customs Union”, MEI provides expertise on trade policies, free movement of goods, and the protection of cultural heritage in line with EU standards. These contributions reflect the ministry’s cross-sectoral role in ensuring coherence and effectiveness in the European integration process.
ENG CONTRIBUTING CHAPTERS		

	tregtare, lëvizjen e mallrave dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore në përputhje me standardet e BE-së. Këto kontribute pasqyrojnë rolin ndër-sektorial të ministrisë në garantimin e koherencës dhe efektivitetit të procesit të integritetit evropian.	
--	--	--